



Albanian-American
Development Foundation



Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë
Departamenti i Letërsisë

KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE
JSTOR

FUSHA E APLIKIMIT: Edukimi dhe Lidërshipi

Titulli i temës së punimit:“Prej tekstit dramatik në fotodramë. Laboratori multikurrikular
“Kështjellë rëre”, Klubi i Dramës, FHF, 2021”

Punoi:Klubi i Dramës

Jorsena Brahimllari

Këze Saliq

Leonora Pula

Majlinda Dedaj

Nekije Shahinasi

Katerina Hysenllari

Omer Fuçia

Bachelor në Gjuhë shqipe dhe Letërsi

Tiranë, 2021

Abstract:

Në këtë laborator kemi aplikuar për herë të parë një tekst dramatik të shkruar nga pesë (5) autore, për të vijuar më tej me procesin fotografik, proceset e përpunimit grafik dhe atë të editorisë, botimin e ekzemplarit fotodramatik “Kështjellë rëre”, duke u mbështetur teorikisht edhe në burimet e Jstore.

Keywords:

- Fotodramë
- Kështjellë rëre
- Mimësis
- Tekst dramatik
- Fokus fotografik
- Imazhe blic
- Graphic design
- Katharsis
- Dramë dhe teatër eksperimental

Hipoteza:

Ideimi ifabulës sënjë teksti dramatik, ideimi e strukturimi sipas teknikave teorike të gjinisëdramatike, prej pesë autoreve studente, kërkoi vullnet dhe vokacion të përbashkët artistik e letrar. Pikërisht ky është edhe qëllimi parësor në formësimin e këtij produkti fotodramatik, unifikimi i të gjitha akteve dhe skenave dhe prezantimi si një produkt i vetëm. Ky është funksioni i ateliesë dhe laboratorit dramatik, eksperimentimi me teksturën, me strukturën, formën dhe përmbajtjen e tekstit dramatik.

Kjo vepër prej laboratorit të Klubit të Dramës, hasi sfida e vështirësi të tipologjive të ndryshme: të kohës, hapësirës së kufizuar etj., por hapi edhe mundësi të komunikimit ndryshe, si dhe kërkimit në bibliotekën digjitale Jstor, si burim informacioni shkencor mbi lëndën. I gjithë procesi, puna preku dimensione shkencore e artistike: kalimin nga procesi dramatik në fiksimin e veprimit përmes fokusit fotografik, më pas teksti dhe fotografia dhe editoria, deri në botimin e produktit fotodramatik “Kështjellë rëre”.

Qëllimi i artikullit:

Aplikimi i laboratorit krijues (tekst- fotografi), gjatë pandemisë, në fushën e dramës dhe fotografisë sjellë në një trajtë të unifikuar mes dy arteve, që imitojnë të njëjtin veprim, përcjellin bashkërisht të njëjtin emocion eprekin ndjeshmërinë e publikut, si element katarstik dramatik. Në këtë artikull do të përcillet puna e kryer në grup dhe fazat e saj, deri në produktin final: botimin e ekzemplarit.

1. Koncepti fotodramë

Sa herë duhet të formësojmë një mendim për letërsinë në tërësi, e për gjininë e dramës në veçanti, vështrimi teorik udhëton përmes një analepse kohore në antikitetin e largët, e ndalet në teorinë e madhe, në Poetikën e Aristotelit.

Aristoteli çdo tekst letrar, përveç poezisë lirike i konsideron si imitim, kështu mimesi/ imitimi shndërrohet në konceptin themelor të gjinisë dramatike. *Po në teorinë aristoreliane ekziston një raport preciz ndërmjet teknikës së komunikimit dhe strukturës së produktit letrar. Nëse mimesi dramatik i jep jetë një strukturë në të cilën marrëdhëniet kohore midis pjesëve riorganizohen, në një sistem narrativ nuk ka marrëdhënie fikse midis zgjatjes së secilës pjesë dhe kohëzgjatjes në kohë të ngjarjeve qëi referohet.*¹

Në këtë mënyrë, formësuam strukturën dramatike të kësaj veprë, përmes teknikës teorike dhe një skeme së lëvizjes së aktantit në skenë, përmes optikës së veprimit në kulmin e shprehisë dhe e fiksimit të lëvizjes, si aksion dramatik- skenik, përmes fokusit fotografik.

Përreth një vit e gjysmë punuam mbi një projekt, si pikë fokale e laboratorit dramatik, mbi një temë që preku jetën dhe zemrën tonë, tërmeti. Kështu nisi aksioni ynë, deri në paraqitjen e dramës *Kështjellë rëre*, përmes fotografisë, me fabul dramatike të bazuar në histori jetësore të vërtetë.

Kjo Fotodramë për Tërmetin e 26 Nëntorit 2019, mban fokusin te shikuesi e lexuesi, që si një përrua rikujton fotodramën e lëvizshme të jetës së tyre e dekodimi i mesazhit, që nuk pushon së qeni lajm. Henry Albert Phillips, shprehete: *Një fotodramë është perfekte kur nuk të lë vend për dyshime, kur nuk ofron asnjë shpjegim, ajo nis dhe nuk përfundon kurrë.*² Kështu, antikja dhe bashkëkohorja, e shkuara dhe e tashmja përjetësohen si imazhe blic në kujtesën e së ardhmes.

Fotodrama *Kështjellë rëre*, nuk shënjon thjesht gurin e parë të themelit në artin fotodramatik në vendin tonë, por shënjon vijimësinë e një tradite të lindur si ide e *Ateliesë dramatike*, për t'u përmbyllur si produkt fotodramatik dhe vizual i *Klubit të Dramës* në Universitetin e Tiranës.

¹Nella teoria aristotelica dal fare poetico esiste un rapporto preciso fra tecnica di comunicazione e strutturazione del prodotto letterario. Mentre la mimesis drammatica dà vita ad una struttura nella quale i rapporti temporali fra le parti sono rigorosamente definiti, in una sistema narrativo non esistono relazioni fisse fra l'estensione di ciascuna parte e la durata nel tempo degli avvenimenti che essa riferisce; [...] Në

-Rebaudo, L. (1992). ARISTOTELE, "POETICA" 18, 5. Studi Classici E Orientali, 41, 217-234. Retrieved May 8, 2021, from <http://www.jstor.org/stable/24184561>

²The perfect photoplay leaves no doubts, offers no explanations, starts nothing it cannot finish. Në:

-Baxstrom, R., & Meyers, T. (2016). Evidence, First Movement: Words and Things. In *Realizing the Witch: Science, Cinema, and the Mastery of the Invisible* (pp. 32-61). NEW YORK: Fordham University Press. doi:10.2307/j.ctt175x2kv.5

2. Kategoria dramatike - aplikimi në vepër

Kthimi në auditor pas përjetimit të një tërmeti të rrallë për vendin tonë dhe ideja e propozuar si një laborator i shkrimit dramatik nga profesoresha jonë Erenestina Gjergji Halili, u prit si një nevojë e të gjithëve për të qenë dëshmitarë - krijues, si dhe kontribues në këtë skenë dramatike e tragjike, qëna rezervoi koha e hapësira jonë. *Tragjedia, pra, është imitimi i një veprimi tërëndësishëm e të përkryer, që ka një madhësi të caktuar, të dhënë me anë të një të folure të ëmbël e të përshtatur me çdo pjesë veç veprimit që shfaqet me anë personash, të cilët veprojnë dhe nuk recitojnë dhe që kryejnë pastrimin e pasioneve me anë të mëshirës e të frikës*³dhe drama është një formë e të treguarit të ngjarjeve serioze.

*Estetikisht e gjendur midis tragjedisë dhe komedisë, ajo përfaqëson një ekuilibër, që mund të gëzojë cilësitë e dy llojeve të mëdha, por që nuk mbizotërohet nga asnjëri prej tyre.*⁴ Kështu ne vendosëm të shkruanim një dramë, jo vetëm për atë çfarë drama përfaqëson, por dhe në shenjë solidariteti, si pjesë e të njëjtit komunitet.

Dhe së fundmi, e projektua për ta shfaqur në Ditën e Librit më 23 prill 2020. Në “Ars Poetica”, Horaci propozon *përbërjen e poezisë dramatike që, mbi bazën e modelit grek, duhet t’i shërbejë edukimit intelektual, moral dhe estetik të një publiku më të gjerë.*⁵

Sintagma si titull (Kështjellë rëre)

Duhej që titulli të jepte për lexuesin, shikuesin, apo dëgjuesin impaktin e parë, që shenja të lidhej me të shënjuarin në mënyrën më konkrete të mundshme. Gjuha dramatike, është një mënyrë e karakterizimit indirekt në dramë, ndaj titulli do të përcaktonte, si qëllim final, dekodimin dhe receptimin e fabulës dramatike.

3. Harmonizimi i tekstit me bashkëautorë

³Aristoteli, Poetika, Buzuku, Prishtinë, 1998, f. 62

⁴Çapaliku, Stefan: Libri i vogël i dramatikës, Tiranë, 2010, f. 22. ³Tsitsiou-Chelidoni, C. (2019).

⁵In his ‘Ars Poetica’ Horace proposes the composition of dramatic poetry that, on the basis of exemplaria Graeca, should serve the intellectual, moral and aesthetic education of a wider public. Indeed, this poetry could well be seen as correcting some of the serious weaknesses that same public seems to suffer from in various places in the poet’s oeuvre. Besides, Horace envisions dramaturgists as exemplary vates who can assume a historically significant sociopolitical role.

Në: Horaz über das römische Drama. Wiener Studien, 132, 171-194. Retrieved May 10, 2021, from <https://www.jstor.org/stable/26735260>

Puna në grup me të njëjtën ide letrare dhe artistike, është një sfidë, që përtej produktit final, indukon disiplinë dhe frymë. Format i stafetës së mendimit artistik dhe realizimit të idesë dramatike, solli nevojën e konsultimit të vazhdueshëm, por edhe të edukimit në distancë, në kushtet e reja të pandemisë, që nga ana e saj ishte një tjetër përvojë panbotërore, në të cilën gjithashtu u gjendëm krejt papritur.

Pasimi i ngjarjeve të ndryshme dramatike, kërkonte konceptet çelës dramatike funksionale, për të cilat audienca, si horizont i pritjes, do të gjykonte më pas.

Në qendër ishin dy familje me standarde të ndryshme jetese e dy jetë vajzash që humbën, si temë qendrore dramatike. *Fabula është një, jo sepse siç besojnë disa, ka një person të vetëm por se një personi mund t'i ndodhin peripeci të shumta, madje të panumërta dhe disa nga to të mos formojnë njësi, gjithashtu veprimet e një personi të vetëm mund të jenë të shumta por këto mos të kenë njësi veprimi.*⁶

Ky pohim aristotelian, tregon thelbin e bashkërendimit të punës sonë, si grup autorësh, që stimuloi edhe raportet ndërnjerëzore, në kohë të papërsëritshme.

U përqëndruam në idetë universale, që vetë gjinia dramatike, si qasje filozofike e estetike shpreh, atë të dashurisë njerëzore! *Aristoteli në Poetikë vendos për të dhënë një rol në ushtrimin ose përmirësimin e ndjeshmërisë morale të një qytetari të pjekur...*⁷

Ky fill, që lidhi teksturën e strukturën dramatike përmbillet me: *Unë jam Diellza, unë do ta dhuroj të gjithë dritën time për ju!*


Tabela më poshtë, tregon skemën grafike, që aksioni dramatik dhe vetë fabula rrugëton. Kjo skemë tregon se, të gjithë aktet e dramës *Kështjellë rëre*, janë të ndërtuara mbi suspansën dramatike, ku pritjet shpërthimi i konfliktit dramatik. Kulmi shënon në Aktin e tretë. Aktet e para kanë një qëndrueshmëri të ngjarjeve, ku më pas konstatojnë në ngritje [rënia e tërmetit] dhe pas rënies rikthehemi sërish aty ku u nisëm, por me humbje jetësh dhe vijueshmëri ngjarjesh të tjera, si pasojë e kataklizmës tragjike...

**Paraqitja grafike e intensitetit të veprimeve të akteve në vepër:*

⁶Aristoteli, Poetika, Çabej, 2006, fq.8

⁷Aristotle in the Poetics sets out to give tragedy a role in exercising or Improving the mature citizen's moral sensibilities.

Në: Ferrari, G. (1999). Aristotle's Literary Aesthetics. *Phronesis*, 44(3), 181-198. Retrieved May 24, 2021, from <http://www.jstor.org/stable/4182618>



4. Realizimi fotografik dhe lidhja e saj me letërsinë

Shkrirja e artit fotografik me letërsinë nuk e ka kufizuar (limituar) lexues-shikuesin, njërin për të krijuar një imazh mes rreshtave dhe tjetrin për të krijuar mes ngjyrave një perceptim. Përkundrazi, ka mundësuar një lidhje më të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë me atë çka do të përcjellë krijuesi, pa zënë kurrë hapësirën e tyre të imagjinatës. *Duke folur historikisht, fotografia lindi si një art i personit: i identitetit të tij, i gjendjes së tij civile, i asaj për të cilën dikush mund të flasë në të gjitha kuptimet e ndryshme të shprehjes, duke mbajtur distancën e trupit.*⁸

Procesi i fotografimit, ndoqi të njëjtën linjë që përcakton Barthes. Fotot kanë në qendër individin dhe shumëllojshmërinë e elementeve mimetikë të tij; përditshmërinë, prejardhjen, kulturën, identitetin dhe shoqërinë ku jetojnë. Kompozicioni i fotografisë ngjan me një fragment të një skene teatri. Të dyja janë me mision të përafërta, në përcimin e mesazhit dhe lëvrimin estetik. Rrëfejnë për *dramatis personae* me *fatumm*, që nuk mund të ndryshojë, ekzistojnë në atë mënyrë, sepse gëzojnë privilegjin (e dhënë nga krijuesi i tyre) e të projektuarit dhe përcjelljes shumë më të madhe, se vetë vdekja e triumfi i tyre.

Në skenën e teatrit, bie perdja, dritat fiken dhe aktorët largohen. Në skenën fotografike, gjithcka mbetet, çdo frymë e personazheve është aty. *Kur e përkufizojmë foton si një imazh të palëvizshëm, nuk nënkuptojmë vetëm se personazhet që ajo portretizon nuk lëvizin, do të thotë se nuk dalin: ato janë anestezuar dhe të dendura, si fluturat.*⁹

⁸ "Storicamente parlando la fotografia è nata come un'arte della persona: della sua identità, della sua propria condizione civile, di quello che si potrebbe parlare in tutte le varie accezioni dell'espressione, il mantenere le distanze del corpo". La camera chiara. Note sur la photographie, Ronald Barthes, 1980, fq. 80

⁹ "Quando si definisce la foto come un'immagine immobile, non si vuole dire solamente che i personaggi che essa ritrae non si muovono, s'intende dire che esse non escono fuori: esse sono anestetizzati e fitti, come le farfalle". Në: La camera chiara. Note sur la photographie, Ronald Barthes, 1980, fq. 58

Fotografitë nuk janë të palëvizshme! Në mendjet e atyre që këqyrin, gjithçka lëviz, emocionet vërshojnë dhe ngjyrat flasin sepse e tërë skena fotografike është e gjallë. *Fotografia është provë, e shtyrë, e ngarkuar, e cila duket se nuk karikaturizon figurën e saj të asaj që portretizon, por vetë ekzistencën e saj.*¹⁰

Vetë origjina dhe kuptimi i termit fotografi (të shkruash me dritë), tregon sesa thelbësore është drita. Fotot janë realizuar nën dritën natyrale të diellit, e cila ka qenë një dritë e butë ose siç thuhet ndryshe e mbytur. Kjo ka çuar në krijimin e kontrasteve midis zonave të hijëzuara dhe atyre të ekspozuara në dritë, që krijojnë stimuj fiziologjik dhe reagim të caktuar emocional. Kjo është arsyeja në Aktin e parë janë përzgjedhur ngjyra të zbehta, për të krijuar tek shikuesi një ndjesi si e fotove të vjetra. Ngjyrat janë shprehëse, teçojnë një shumësi kuptimesh dhe ndjenjash.

Në Aktin e dytë ngjyrat bëhen gjeneruese të emocioneve të tjera. Nuk ka shumë dritë. Gjestet si lëvizje natyrale të personave, krijojnë me shumë besueshmëri tek shikuesi.

Akti i tretë është një pikë takimi, mes karakteresh dhe fatesh njerëzish. Tonalitet e përdorura ndryshojnë brenda vetë aktit. Sendet, përcjellnin idenë e lëvizjes së tyre për të treguar që po bie tërmet, si fakt dramatik. Janë përdorur efekte deri në arritjen e aludimit e të qenit vërtetë në një studio televizive. Në fund të aktit, shikimi i një personi dramatik takohet me shikimin e lexuesit, dhe kjo e lejon manifestimin e gjithë anën shpirtërore që ka synim ai të përcjellë. Tonalitet janë blu, më të ftohta, të qarta, që të tërheqin, edhe pa dashur, vëmendjen. Fotoja e fundit është një përzierje efektsh, dhe sfondi blu lejon që subjekti të ketë gjithë vëmendjen e duhur.

Fotografia dhe letërsia, harmonizimi mes tyre krijoi diçka të re, duke vënë në pah ngjashmëritë mes tyre dhe njëkohësisht duke krijuar diçka të re. Çdo shkrimtar është një fotograf, dhe çdo fotograf është një rrëfimtari i mirë. Sepse detaji krijon imazhin. Është e rëndësishme ta kujtojmë historinë, ta njohim atë në mënyrë që ajo të mos përsëritet në rastin kur ajo e dëmton shoqërinë. *Prandaj të shkrepurit fotografi do të thotë në një farë mënyre që të kujdesesh për botën.*¹¹

5. Realizimi grafik artistik

Pas realizimit të tekstit dhe fotografive, dy aspektet themelore nevojitej të prezantoheshin në një linjë ideore e strukturore, si produkt të vetëm.

Programet si: Adobe Photoshop, Adobe Illustration, Adobe Indesign, Lightroom, të përdorura në këtë proces të vështirë, profesional dhe në avantgardë, na mundësuan shpërfaqjen me cilësi të idesë dramatike dhe detajimin e imazhit artistik, në funksion të veprës e fabulës së saj.

Janë punuar mbi 20 draftetë një fotografietëvetme. Për shembull, retë e krijuara duhej të kishin një unitetperfekt me fotot dhe mbi të gjitha, të krijojnë hapësirën kohore dramatike, të shprehnin idenë dramatike dhe të njësoheshin me fabulën.

Teksti dramatik, me synim vënie në skenë, nuk e pati mundësinë e lojës në skenë, për shkak të pandemike, ndaj ishte një sfidë e re ajo e teknologjisë prezantuese. *Këto çështje dhe fakti se kishim një mungesë edukative të produktit, tashmë duket se arti i kryer për internetin, trajtohet si një*

¹⁰ "La fotografia è un'evidenza, spinta, caricata, che sembra caricaturizzare non già la sua figura di ciò che essa ritrae, ma la sua stessa esistenza". Në: La camera chiara. Note sur la photographie, Ronald Barthes, 1980, fq. 115

galeri në të.¹¹Gjithashtu, tashmë, ne studentet me ndihmën e profesorëve tanë po bëhemi të vetëdijshëm për shtresat e shumta të artit dhe sesi marrdhenia e saj me teknologjinë po rritet.¹² Kjo ndodh sepse prej shekujsh, teknologjia ka siguruar mjetet, materialet dhe proceset, te cilat kanë ndihmuar për të realizuar aspektet artistike dhe krijuese.¹³, si ndodhi edhe në rastin tonë.

Mbi 200 foto të realizuara, prej nga 136 u konsideruan finale, mbi 10 draftekopertinash dhe 2 muaj process montazhi mes vështirësishë si orari policor, koordinimi i orareve tona mësimore, etj.

6. Raporti dhimbje-ngadhënjim, dikotomi jetësore-artistike

Thanatos është në të vërtetë një temë shumë delikate. Sa larg, po aq edhe afër, ekzistenca jonë është e lidhur me vdekjen. Sipas filozofisë së Martin Heidegger për të, *të qenit një qenie humane, është të qenit drejt vdekjes. Kjo do të thotë se ontologjia e Heideggerit është vdekja.*¹⁴*Ontologjia është dega e filozofisë që studion koncepte të tilla si ekzistenca, qenia, të qenit dhe realiteti.*¹⁵ Ai e konsideron vdekjen si aspektin vendimtar të ekzistencës njerëzore.Për Heideggerin, *vdekja është “fundi” i të qenit, që do të thotë, fundi i ekzistencës në këtë botë.*¹⁶

¹¹CURTI, DENIS, *Scattare una fotografia significa prendersi cura del mondo*, TEDxMacerata, You Tube. <https://www.youtube.com/watch?v=6REcUdG5JII>

¹²Org: This issue and the largely absent educational piece of the product, that is, art made for the internet and purpose built for internet-as-gallery, are addressed.

WILKS, JUDITH, et al. “Digital Technology in the Visual Arts Classroom: An [Un]Easy Partnership.” *Studies in Art Education*, vol. 54, no. 1, 2012, pp. 54–65. JSTOR, www.jstor.org/stable/24468130.

¹³Org: Art teachers are striving to assist their students to become aware of the layered contexts of the art world and it’s evolving relationship with technology.

WILKS, JUDITH, et al. “Digital Technology in the Visual Arts Classroom: An [Un]Easy Partnership.” *Studies in Art Education*, vol. 54, no. 1, 2012, pp. 54–65. JSTOR, <https://www.jstor.org/stable/24468130>.

¹⁴Org: Indeed over the centuries, technology has provided the tools, materials and processes that have aided artistic and creative expression. Robyler & Doering, 2010, pg.366.

WILKS, JUDITH, et al. “Digital Technology in the Visual Arts Classroom: An [Un]Easy Partnership.” *Studies in Art Education*, vol. 54, no. 1, 2012, pp. 54–65. JSTOR, www.jstor.org/stable/24468130.

¹⁵For Martin Heidegger, the being of human being is being-towards-death. This means that Heidegger ontologies is death. He considers death the decisive aspect of human existence.For Heidegger, death is ‘the “end” of being, that is, of being-in-the-world’. Nè:Fuchs, C. (2020). *Death and Love: The Metaphysics of Communication*. In *Communication and Capitalism: A Critical Theory* (pp. 313-336). London: University of Westminster Press. doi:10.2307/j.ctv12fw7t5.17

¹⁶Ontology is the branch of philosophy that studies concepts such as existence, being, becoming, and reality.Nè: “Ontology”, from Wikipedia, the free encyclopedia: <https://en.wikipedia.org/wiki/Ontology>

¹⁷He considers death the decisive aspect of human existence.For Heidegger, death is ‘the “end” of being, that is, of being-in-the-world’.

Nè: Fuchs, C. (2020). *Death and Love: The Metaphysics of Communication*. In *Communication and Capitalism: A Critical Theory* (pp. 313-336). London: University of Westminster Press. doi:10.2307/j.ctv12fw7t5.17

Të ekzistuarit, të mbijetuarit është sfida më e madhe njerëzore.

Dëlira, edhe pse jo fizikisht, *dramatis personae*, flet nga “e përtejtmja” duke e rimishëruar veten në ndërgjegjen e kujtudo e duke përcjellë mesazhe shumë të forta, mesazhe udhërrëfyese drejt së mirës. Ndërhyrja e saj në skenë është një *deus ex machina*, që i referohet ndërhyrjes së një hyjnie në veprimin e një drame për të zgjidhur një konflikt dhe, shpesh, për ta sjellë veprimin në një përfundim. Edhe pse jo një hyjni, Dëlira vjen nga “e përtejtmja”.

Veprën dramatike mbyllet me Diellëzën, një fëmijë, qenie të pafajshme, qëçel shpresë e sjell agimin, pas një nate kaotike e tragjike.

Bibliografia:

1. Rebaudo, L. (1992). ARISTOTELE, "POETICA" 18, 5. *Studi Classici E Orientali*, 41, 217-234. Retrieved May 8, 2021, from <http://www.jstor.org/stable/24184561>
2. Baxstrom, R., & Meyers, T. (2016). Evidence, First Movement: Words and Things. In *Realizing the Witch: Science, Cinema, and the Mastery of the Invisible* (pp. 32-61). NEW YORK: Fordham University Press. doi:10.2307/j.ctt175x2kv.5
3. Aristoteli, *Poetika*, Buzuku, Prishtinë, 1998, fq. 62
4. Çapaliku, Stefan, *Libri i vogël i dramatikës*, Tiranë, 2010, fq. 22.
5. Horaz über das römische Drama. *Wiener Studien*, 132, 171-194. Retrieved May 10, 2021, from <https://www.jstor.org/stable/26735260>
6. Aristoteli, *Poetika*, Çabej, 2006, fq. 8.
7. Ferrari, G. (1999). Aristotle's Literary Aesthetics. *Phronesis*, 44(3), 181-198. Retrieved May 30, 2021, from <http://www.jstor.org/stable/4182618>
8. BARTHES, ROLAND, *La camera chiara. Note sur la photographie*, 1990, fq. 80, fq.58, fq. 115.
9. CURTI, DENIS, *Scattare una fotografia significa prendersi cura del mondo*, TEDxMacerata, You Tube. <https://www.youtube.com/watch?v=6REcUdG5JII>
10. WILKS, JUDITH, et al. "Digital Technology in the Visual Arts Classroom: An çUn] Easy Partnership." *Studies in Art Education*, vol. 54, no. 1, 2012, pp. 54–65. JSTOR, www.jstor.org/stable/24468130
11. Fuchs, C. (2020). *Death and Love: The Metaphysics of Communication*. In *Communication and Capitalism: A Critical Theory* (pp. 313-336). London: University of Westminster Press. doi:10.2307/j.ctv12fw7t5.17

12. "Ontology", from Wikipedia, the free encyclopedia: <https://en.wikipedia.org/wiki/Ontology>